

**LIGJI Nr. 04/L-002  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-010 PËR NOTERINË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT  
NR. 03/L-010 PËR NOTERINË**

**Neni 1**

1. Në tërë tekstin e ligjit bazik togfjalëshi “**President i Gjykatës**” zëvendësohen me togfjalëshin “**Kryetar i Gjykatës**”.
2. Në tërë tekstin e ligjit bazik togfjalëshi “**President i Odës**” dhe “**Nën-President**” zëvendësohen me togfjalëshin “**Kryetar i Odës**” dhe “**Nën-Kryetar**”.

**Neni 2**

Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 2. në rreshtin e fundit të këtij paragrafi fshihet togfjalëshi: “në pikën d” dhe shtohet togfjalëshi “nën- paragrafi 1.5., i paragrafit 1. të këtij neni”.

**Neni 3**

Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2 ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

2. Kandidatet që plotësojnë kushtet për praninë në shërbimin noterial, në përputhje me Ligjin mbi Noterinë, mund të parashtrajnë kërkesë, për të hyrë në provimin për noter, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

**Neni 4**

Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 4. fjalia: “ Padija mund të paraqitet nga kandidatët e pakënaqur në afat prej tetë ( 8) ditësh nga publikimi i vendimit”, fshihet nga teksti i dispozitës.

**Neni 5**

Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 2 ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

2. Vulat Noteriale duhet të jenë në përputhje me modelin rrethor të identifikuar lehtë, dhe përmbajnë emrin dhe mbiemrin e Noterit përkatës si dhe selinë e zyrës së tij apo saj. Karakteristikat e përgjithshme të vulave noteriale, bashkë me përshtatjet e nevojshme duhet të jenë në përputhje me dizajnin e vulave, siç përcaktohet me Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.

## **Neni 6**

Neni 30 i ligjit bazik, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, fshihet nga teksti i dispozitës.

## **Neni 7**

Neni 44 i ligjit bazik fshihet ndërsa neni 45 bëhet neni 44, nenet 46 deri në 77, rinumërohen me numrat 45 deri në 76.

## **Neni 8**

Titulli i nenit 68 i ligjit bazik “ Komisioni dhe Presidenti i Odës” ndryshohet dhe riformulohet “Komisioni dhe Kryetari i Odës”.

## **Neni 9**

1. Neni 76 i ligjit bazik, paragrafi 10. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

10. Ne afat prej një (1) viti, pas hyrjes në fuqi të plotësim ndryshimit të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë propozon Ligjin për trashëgimi të Kosovës dhe Ligjin për procedurën jokontestimore, që paraqitet e nevojshme nga ky ligj.

2. Neni 76 i ligjit bazik, pas paragrafit 10, shtohet paragrafi i ri 11, si vijon:

11. Ministria e Drejtësisë nxjerr akte nënligjore me qëllim të zbatimit të Ligjit për Noterinë.

## **Neni 10**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-002**  
**21 korrik 2011**

**Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**